



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. 011/01-8457 /2018

Dt. 30.03.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 10 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me dt.30.03.2018, pas diskutimeve lidhur me pikën e 14-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës së KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në parcelën nr. 1116/2, ZK Gjakovë Qytet në Sipërfaqe $S=13.52m^2$ për vendosjen e Stabilimentit Shpërndarëse të dimensionit $(2.6 \times 5.2)m$, e miratoi këtë:

V e n d i m

Për dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim

1. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në kohëzgjatje prej 99 viteve, pa kompensim material, në pjesën e ngastrës Kadastrale me nr. 1116/2, ZK Gjakovë qytet në pronësi PSH. Kuvendi Komunal, për vendosjen e Stabilimentit Shpërndarës të dimensionit $(2.6 \times 5.2)m$, në Sipërfaqe $S=13.52m^2$.
2. Autorizohen organet e administratës komunale që të ndjekin procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim KEDS-it, pronën e cekur në pikën e 1-rë të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës .
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
 - Drejtorisë për Kadastër Gjcodezi dhe Pronë.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit,



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Z. Anton Shala